

JETËSHKRIM
Marsida Xhaferllari
Janar 2019

I. Të dhëna personale

Emri: Marsida
Mbiemri: Xhaferllari
Dita dhe vendlindja: 6 Mars 1975; Tiranë
E-mail: mxhafellari@gmail.com
mxhaferllari@kld.al
Cel: + 355692089431

II. Arsimimi

1997-2000 Shkolla e Magjistraturës, Tiranë
Magjistrate (profili gjyqtar)

1993-1997 Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Juriste

III. Përvoja profesionale

Jan.2013 – aktualisht Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sot Këshilli i Lartë Gjyqësor
Kryeinspektore

- Drejtimi, mbikëqyrja dhe koordinimi i veprimtarisë së Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që përbëhet nga 15 inspektorë në dy seksione;
- Drejtimi i procesit të zbatimit të sistemit të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve deri në hartimin e projektakteve përfundimtare të vlerësimit për çdo gjyqtar, duke përfshirë edhe raportet profesionale për procesin e rivlerësimit kalimtar për periudhën 2017-2018;
- Drejtimi, mbikëqyrja dhe koordinimi i procesit të inspektimeve tematike në gjykata bazuar në ankesat e qytetarëve apo në vendimet e KLD-së;
- Mbikëqyrja e veprimtarisë së kryetarëve të gjykatave nëpërmjet raportimeve dhe inspektimeve periodike;
- Rekomandimi i procedimeve disiplinore të gjyqtarëve kur konstatohen shkelje të rënda të ligjit gjatë inspektimeve;
- Rekomandimi i ndryshimeve ligjore apo reformave strukturore për të adresuar problemet e identifikuara gjatë inspektimeve apo studimeve analitike;
- Hartimi i Raportit Vjetor drejtuar KLD-së mbi veprimtarinë e Inspektoratit;

- Raportimi mbi gjyqësorin dhe të drejtat e njeriut në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE dhe në mekanizma të tjerë ndërkombëtarë;
- Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstitucionale mbi reformën në drejtësi apo për hartimin e legjislacionit përkatës.

Gusht 2011-Jan. 2013

Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë

Drejtore e Përgjithshme

- Drejtimi, mbikëqyrja dhe koordinimi i Drejtorisë së Përgjithshme, e cila përbëhet nga 4 Drejtori, 36 vartës.
- Monitorimi i zbatimit të ligjit përmes inspektimeve në gjykata, prokurori dhe agjencitë ekzekutive në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të profesioneve të lira si noterët dhe përmbaruesit.
- Rekomandimi i procedimeve disiplinore kur gjatë inspektimeve u konstatuan shkelje të rënda të ligjit.
- Rekomandimi i ndryshimeve ligjore apo reformave strukturore ekzekutive për zgjidhjen e problemeve të identifikuar gjatë inspektimeve dhe studimeve analitike.
- Hartimi, rishikimi dhe zbatimi i politikave mbi Sistemin e Drejtësisë bazuar në analiza gjithëpërfshirëse, studime dhe raporte të inspektimit.
- Hartimi i Raportit Vjetor të Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet në Prokurori drejtuar Kuvendit, si dhe i Rekomandimeve Vjetore të Këshillit të Ministrave drejtuar prokurorisë për luftën kundër kriminalitetit.
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor midis Shqipërisë dhe shteteve të huaja (ekstradimet, transferimin e procedimeve, transferimin e të dënuarve, njohjen e vendimeve të huaja, letërporositë) në çështjet penale, civile, administrative dhe tregtare, ku Ministria e Drejtësisë është Autoriteti Qendror.
- Negociimi dhe hartimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar.
- Raportimi mbi reformën në gjyqësor dhe të drejtat e njeriut përgjatë procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, si dhe në kuadër të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Shtat. 2008-Gusht 2011

Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit
Drejtore e Përgjithshme

- Drejtimi, mbikëqyrja dhe koordinimi i Drejtorisë së Përgjithshme, të përbërë nga 2 Drejtori, 17 vartës;
- Planifikimi i Programit Vjetor Legjislativ për Ministrinë e Drejtësisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, si dhe monitorimi i zbatimit të tij;

- Hartimi i legjislacionit (ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, Udhëzime dhe Urdhra) mbi Sistemin e Drejtësisë dhe të Drejtat e Njeriut si: Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, Ligjin “Për Konferencën Gjyqësore Kombëtare”, Ligjin “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, Ligjin “Për parandalimin e krimit të organizuar nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive”, ndryshimet në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, Ligjin “Për shërbimin privat përmbarimor” dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, ndryshimet në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH”, ndryshimet në Ligjin “Për policinë gjyqësore”, ndryshimet në Ligjin “Për partitë politike”, Ligjin “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”, Ligjin “Për ndërmjetësimin”, Ligjin “Për profesionin e avokatit në RSh”, Ligjin “Për faljen” etj.
- Përgatitja e mendimeve mbi legjislacionin e hartuar nga institucionet e tjera shtetërore mbi përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën, legjislacionin shqiptar dhe me teknikat legjislative;
- Hartimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe përgatitja e mendimeve/komenteve përgjatë fazave të negociimit për marrëveshjet e hartuara nga institucione të tjera shtetërore;
- Përfaqësimi i Këshillit të Ministrave në komisionet parlamentare në rastet e shqyrtimit dhe të miratimit të legjislacionit të hartuar nga Ministria e Drejtësisë.
- Hartimi, rishikimi dhe zbatimi i politikave mbi Sistemin e Drejtësisë bazuar në analiza gjithëpërfshirëse, studime dhe raporte;
- Raportimi mbi reformën në gjyqësor dhe të drejtat e njeriut përgjatë procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, si dhe në kuadër të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Dhjet. 2007-Gusht 2008

Ministria e Drejtësisë
Këshilltare e Ministrisë të Drejtësisë

- Rekrutuar si gjyqtare në strukturat juridiko-profesionale për të këshilluar Ministrin e Drejtësisë mbi çështjet e gjyqësorit, të të përndjekurve politikë dhe mbi çështjet e pronësisë.

Shtat.2000-Dhjet.2007

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Gjyqtare (Kolegji Penal)

Tet.1999-Shtat.2000

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Gjyqtare (Seksioni Familjar, Kolegji Civil)

a. Veprimtari akademike dhe grupe pune

2017-2018	Bashkëautore dhe Anëtare e Bordit Shkencor të Komentarit Elektronik mbi Ligjin për Statusin dhe Ligjin për Qeverisjen, një projekt i zbatuar nga Euralius me qëllim sigurimin e një platforme për profesionistët e ligjit dhe publikun me njohuri mbi qëllimin dhe përmbajtjen e parashikimeve të ligjeve të reformuara.
Shtat. 2015 – Korr. 2016	Anëtare (përfaqësuese e KLD) e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Kuvendit për Reformën në Drejtësi për të hartuar legjislacionin mbi gjyqësorin dhe financimin e gjyqësorit.
Shtat. 2015 – Qersh. 2016	Anëtare e Grupit të Punës “Pavarësia dhe përgjegjshmëria e gjyqësorit”, i ngritur nga Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ) për të zhvilluar një set treguesish për vlerësimin e pavarësisë dhe të përgjegjshmërisë së Gjyqësorit në një system gjyqësor shtetëror. Ky grup pune u finalizua me Raportin e ENCJ 2014-2015 “Pavarësia dhe përgjegjësia e gjyqësorit”, të miratuar nga Asambleja e ENCJ
Shtat. 2014 – Qersh. 2015	Anëtare e Grupit të Punës “Mbi zhvillimin e standardeve minimale gjyqësore V”, i ngritur nga Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ) për të zhvilluar një set standardesh minimale dhe treguesit përkatës në fushën e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve
Shtat. 2012-2014	Anëtare e Grupit të Punës për <i>e-learning</i> mbi alternativat e burgimit si zgjidhje për mbipopullimin në burgje në kuadër të Programit të Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionet Ligjore (Programi HELP).
Maj 2007-aktualisht	Shkolla e Magjistraturës Eksperte në Programin e Trajnimit Vazhdues për lëndë që lidhen me të drejtën publike
2010-aktualisht	Shkolla e Magjistraturës Pedagoge e Jashtme e të Drejtave të Njeriut, në Programin e Trajnimit Fillestar
Tet. 2005-Qer. 2007	Shkolla e Magjistraturës Lehtësuese në Programin e Trajnimit Vazhdues
2012-2014	Universiteti Jo-publik “Illyria”, Fakulteti i Drejtësisë Lektore e të Drejtës Kushtetuese në Programin e Ciklit të Dytë

2009-2012
 Universiteti Jo-publik “Illyria”, Fakulteti i Drejtësisë
Lektore e të Drejtave të Njeriut

- Trainere e Skuadrës së Studentëve që konkuroi dhe fitoi në Konkursin Europiano-Shqiptar në 2012 (gjqy imitues) për të Drejtat e Njeriut organizuar nga Misioni Euralius III.

2007-2009
 Universiteti Jo-publik “Kristal”, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë
Lektore e të Drejtave të Njeriut

b. Aktivitete të tjera

2013 – aktualisht
Përfaqësuese e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në çështjet gjyqësore në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese

Shkurt 2008-Jan. 2013
Përfaqësuese e Këshillit të Ministrave në mbi 50 gjykime pranë Gjykatës Kushtetuese me objekt shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve normative (ligje, marrëveshje ndërkombëtare, vendime dhe udhëzime të Këshillit të Ministrave).

20.07.2009
 Licencuar si **Avokate** nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (numri 3859 i licencës)

Dhjet.2011-Jan. 2013
Anëtare e Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve

Korr.2009-Jan. 2013
Anëtare e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumtorëve

Korr.2009-jan. 2013
Anëtare e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës

2008-2011
Përfaqësuese e Ministrisë të Drejtësisë në Komisionin e Vlerësimit të Provimeve të Pranimit në Avokati

Shtat.2008-Gusht 2011
Anëtare e Bordit Drejtues të Institutit të Sigurimeve Shoqërore

Dhjet.2003-Dhjet.2005
Anëtare e Komisionit të Etikës në Konferencën Gjyqësore Kombëtare

IV. Publikime dhe dokumente kyçe

2017
 Personi kyç në hartimin e Manualit për Hetimet Disiplinore ndaj Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Publikim Online i Misionit Euralius, me financim të BE-së (Misioni Euralius IV).

Shkurt 2015	Hartuesja kryesore e Studimit Vlerësues mbi Ngarkesën e Punës në Gjykatat Administrative në Shqipëri, miratuar nga KLD më 15 mars 2015
Jan. 2014	Autore e Manualit për gjyqtarët “Për drejtësinë administrative”, i botuar me asistencën e Prezencës së OSBE Tiranë, për të shpjeguar legjislacionin e hartuar dhe të miratuar gjatë përvojës në detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Kodifikimit
2012 – 2016	Rishikuese e Gazetës së Jurisprudencës Shqiptare (GAJUS), botim elektronik i përmuajshëm me sinteza të vendimeve mujore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Nëntor 2012	Hartuesja kryesore e Manualit të parë të Inspektiveve në Gjyqësor, i zhvilluar në cilësinë e Drejtores së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë me grup pune, të asistuar nga partnerët ndërkombëtarë (Misioni Euralius III).
2011-2012	Personi kyç teknik për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të të Drejtave të Pronësisë, 2013-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 27 Qershor 2012.
2011-2012	Personi kyç teknik në Ministrinë e Drejtësisë për Hartimin e Planit Qeveritar të Veprimit për adresimin e 12 Rekomandimeve në Procesin e Integritimit të Shqipërisë në BE (e ngarkuar për tre Rekomandimet nr. 7 “Shteti i së Drejtës”, nr. 10 “Të drejtat e pronësisë” dhe nr. 12 “Trajtimi njerëzor i të dënuarve”).
2011	Autore e artikullit “Ligje ‘me shumicë’”, botuar në botimin <i>Obiter Dictum</i> , për shpjegimin e disa çështjeve kushtetuese në procesin legjislativ në Shqipëri.
2010-2011	Personi kyç teknik për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2011 – 2013, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 20.07.2011.
2010-2011	Drejtuese e ekipit të ekspertëve shqiptarë për rishikimin e Manualit për Hartimin e Legjislacionit dhe shtimin e një Aneksi për Rregullat si Legjislacioni duhet të Shmangë Korrupsionin – në cilësinë e Drejtores së Përgjithshme të Kodifikimit, asistuar nga projektet Euralius II dhe PACA.
2011	Eksperte e Qeverisë Shqiptare në procesin e Rishikimit nga Shqipëria dhe Suedia të zbatimit nga Bullgaria të neneve 15- 42 i Kapitullit III “Kriminalizimi dhe zbatimi i ligjit” dhe të neneve 44–50 të Kapitullit IV, “Bashkëpunimi ndërkombëtar” i Konventës të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në ciklin e rishikimit 2010-2015.

- 2010 Bashkëautore e Manualit për gjyqtarë dhe prokurorë “Zbatimi i Masave Alternative në Shqipëri”, i përgatitur nën kujdesin e OSBE për shpjegimin e legjislacionit të ri mbi Dënimet Alternative.
- 2010 Personi kyç teknik në Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e përgjigjeve të Pyetësorit të Komisionit Evropian, sidomos për Kriterin Politik dhe Kapitullin 23 “Të drejtat e njeriut”.

V. Gjuhët e huaja

Anglisht	Rrjedhshëm
Italisht	Shumë mirë
Frengjisht	Pak

Referencat jepen me kërkesë.

Deklaroj se autorizoj trajtimin e të dhënave të mia personale sipas këtij jetëshkrimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.